



PËRZGJEDHJA E KRYEPROKURORËVE

(Raport i monitorimit të procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe Kryeprokurorit të pesë (5) Prokurorive Themelore)



Prishtinë, Dhjetor 2024

Autore: Albijona Hoxhaj

Redaktorë: Ehat Miftaraj, Betim Musliu, Gzim Shala dhe Arrita Reznqi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.


Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) – Departamentit të Shtetit Amerikan, apo të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Dhjetor, 2024

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	4
2. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorëve.....	5
3. Rrjedha e procesit për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit	6
4. Rrjedha e procesit për përzgjedhjen kryeprokurorëve të prokurorive themelore	8
5. Transparenca e procesit	8
6. Barazia gjinore	9

1. Përmbledhja ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka monitoruar procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorëve të Prokurorisë së Apelit dhe pesë Prokurorive Themelore (Prizren, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Ferizaj). Bazuar në gjetjet e monitorimit të IKD, ky proces vlerësohet si proces kryesisht i drejtë dhe meritohet, me përjashtim të procesit të Prokurorisë së Apelit ku u evidentuan një numër më i theksuar i problemeve.

Sa i përket proceseve të përzgjedhjes së kryeprokurorëve të prokurorive themelore, IKD gjeti se procesi ishte përgjithësisht i drejtë, meritohet dhe transparent. Panelet vlerësuese aplikuan një qasje të barabartë ndaj kandidatëve dhe dallimet në poentime ishin brenda kufijve të vlerësimit të lirë. Në lidhje me këto, IKD e vlerësoi si problematike arsyetimin duke u referuar në performancën e kandidatëve. Në disa raste, poentimi dhe arsyetimet e dhëna nga anëtarët e paneleve vlerësuese përfshinin vlerësimet e performancës së kaluar të kandidatëve, edhe pse këto janë kritere formale për t'u pranuar në garë dhe jo për të ndikuar në vlerësimin e kritereve për përzgjedhje të Kryeprokurorëve. Përdorimi i këtij kriteri paraqet vlerësim të dyfishtë derisa mos aplikimi i këtij arsyetimi tek të gjithë kandidatët paraqet një lloj pabarazie. Për këtë arsye, IKD vlerëson se aplikimi i këtij kriteri duhet të shmanget në të ardhmen.

Sa i përket procesit për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, IKD ka evidentuar disa probleme. Fillimisht, IKD ka evidentuar diskrepancë të theksuar në vlerësimin e kandidatëve nga anëtarët e panelit vlerësues, ku për të njëjtin kandidat, pikët për të njëjtat kritere ndryshonin ndjeshëm. Kjo krijoi perceptimin e preferencave personale të anëtarëve të panelit në raport me kandidatët për Kryeprokuror të Prokurorisë së Apelit. Tutje, sa i përket këtij procesi, IKD evidentoi se në një rast, njërit prej kandidatëve nuk iu parashtrua një pyetje e cila i ishte parashtruar të gjithë kandidatëve të tjerë. Derisa në një rast tjetër, në bazë të monitorimit, IKD vlerëson se një pyetje nuk ishte mjaftueshëm e qartë.

Procesi ishte përgjithësisht transparent, me përfshirjen e monitoruesve të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë. Megjithatë, panelet vlerësuese nuk siguruan qasje të plotë në arsyetimin e poentimit të dhënë, duke ofruar këto dokumente vetëm në shikim.

Sa i përket barazisë gjinore, pjesëmarrja e grave ishte shumë e ulët, ku nga 15 kandidatë gjithsej, 5 prej tyre ishin gra dhe 10 ishin burra. Nga gjithsej gjashtë (6) prokurori, vetëm në dy (2) prej tyre pati kandidate gra derisa në katër (4) prokurori të tjera gara zhvillohej në mes të burrave. Në të ardhmen, KPK duhet ta adresojë këtë situatë në kuptim të nenit 4 të Ligjit për Barazi Gjinore.

Përfundimisht, monitorimi nga IKD konfirmon se procesi ka qenë kryesisht meritohet dhe transparent për shumicën e pozitive, me disa probleme më të theksuara në procesin për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.

2. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorëve

Me datë 21 tetor 2024, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka publikuar konkurset për Kryeprokuror të Prokurorisë së Apelit dhe pesë (5) Prokurorive Themelore: Prizren, Pejë, Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj.

Me datën 10 dhjetor 2024, KPK ka ftuar Organizatat Joqeveritare (OJQ) për të monitoruar procesin e intervistimit të kandidatëve për Kryeprokuror të pesë (5) Prokurorive Themelore dhe asaj të Apelit.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) i është përgjigjur ftesës për monitorim të këtij procesi.

Për pozitën e Kryeprokurorit në gjashtë (6) prokuroritë e lartcekura, kanë kandiduar gjithsej 15 kandidatë, 10 burra dhe 5 gra.

Procesi i intervistimit të kandidatëve është mbajtur me datat 13, 16 dhe 17 dhjetor 2024. Me 13 dhjetor 2024 është zhvilluar procesi i intervistimit të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë së Apelit, me 16 dhjetor 2024 është zhvilluar procesi i intervistimit të kandidatëve për kryeprokurorë të prokurorive themelore në Gjilan, Ferizaj, dhe Mitrovicë, derisa me 17 Dhjetor 2024 është zhvilluar procesi i intervistimit të kandidatëve për kryeprokurorë të prokurorive themelore në Pejë dhe Prizren.

Intervistimi i kandidatëve për kryeprokurorë të gjashtë (6) prokurorive është monitoruar nga partnerët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile.

Sa i përket procesit për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, më i suksesshmi sipas Panelit Vlerësues ishte prokurori Agron Bajrami me 78.4 pikë, pas tij është vlerësuar prokurorja Sebahate Sinani me 73.8 pikë, pasuar nga Arben Ismajli me 73 pikë, Shkëlzen Ibrahimimi me 72.4 pikë, të cilët do të shkojnë për votim në Këshill. Ndërsa, nuk kanë kaluar prokurorja Sheribane Selimi, e cila mori 66.8 pikë dhe prokurorja Ikramije Bojaxhiu me 65 pikë.

I vetmi në garë për Prokurorinë Themelore në Gjilan, ishte Kryeprokurori aktual Arben Kadriu, i cili nga Paneli Vlerësues u poentua me 93.6 pikë.

Në garë për Prokurorinë Themelore të Ferizajt ishin prokurori special Burim Çerkini dhe prokurori Ismet Rrahmani. Çerkini u vlerësua me 93.4 pikë, ndërsa Rrahmani më 76 pikë. Të dy do të shkojnë në Këshill për votim.

Për të parin e Prokurorisë në Mitrovicë, në fazën e intervistimit ishin prokurorët Shpëtim Peci dhe Zef Prendrecaj. Mirëpo, Paneli Vlerësues nuk ua dha pikët e duhura për të shkuar në votim asnjërit prej tyre. Prokurori Peci u vlerësua me 68.8 pikë, ndërsa prokurori Prendrecaj me 63.6 pikë.

Për Prokurorinë e Pejës në garë ishin prokurori Ersan Qavolli, Lumturije Vuçetaj dhe Sanije Gashi-Seferi. Qavolli u vlerësua me më së shumti pikë – 91.8, Lumturije Vuçetaj me 88 pikë dhe Sanije Gashi-Seferi me 71 pikë.

Kandidati i vetëm për Prokurorinë Themelore të Prizrenit, prokurori Petrit Kryeziu, nga Paneli u vlerësua me 97.6 pikë.

3. Rrjedha e procesit për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit

Më 13 dhjetor 2024, Paneli vlerësues i KPK-së, ka zhvilluar intervistat me kandidatët për Kryeprokuror të Prokurorisë së Apelit. Kandidatë për këtë pozitë ishin prokurorët: Agron Bajrami, Arben Ismaili, Ikramije Bojaxhiu, Sebahate Sinani, Sheribane Selimi dhe Shkëlzen Ibrahim. Në ditën e parë të intervistave për Kryeprokuror të Apelit, pyetjet kanë qenë të përgjithshme, të ndara në katër fusha: 1) koncept-dokumenti dhe prezantimi i kandidatit, 2) integriteti i kandidatit, 3) aftësitë udhëheqëse dhe menaxheriale dhe 4) njohuritë profesionale dhe teknike.

Sa i përket këtij procesi, IKD ka evidentuar disa probleme. Fillimisht, duhet theksuar se është e çuditshme diskrepanca e vlerësimit të kandidatëve për këtë pozitë. Ka raste kur njëri anëtar i panelit vlerësues e ka vlerësuar me pikë maksimale njërin kandidat përkitazi me një kriter të caktuar. Ndërsa, kandidati i njëjtë, për kriterin e njëjtë, është vlerësuar trefish më pak nga i paneli vlerësues. Deri në një masë, kjo është e shprehur edhe në raport me një kandidat tjetër për kryeprokuror.

Edhe nëse i shohim arsyetimet e vlerësimeve, ka dallime të theksuara në vlerësimin e një kandidatit, ku të njëjtin kandidat njëri anëtar i panelit e vlerëson në mënyrë shumë pozitive, derisa kandidati i njëjtë vlerësohet në mënyrë shumë negative nga ana e anëtarit tjetër vlerësues.

Koncept-dokumenti dhe prezantimi i kandidatit	28	20	25	25	10
Integriteti i kandidatit	20	20	18	20	18
Aftësitë udhëheqëse dhe menaxheriale	30	15	28	30	10
Njohuritë profesionale dhe teknike	17	10	18	15	15

Tabela 1: Vlerësimet e anëtarëve për një kandidat për Kryeprokuror.

**Koncept-dokumenti dhe prezantimi i 15 29 18 20 30
kandidatit**

Integriteti i kandidatit 10 20 12 12 20

Aftësitë udhëheqëse dhe menaxheriale 15 30 18 15 30

Njohuritë profesionale dhe teknike 10 19 12 10 20

Tabela 2: Vlerësimet e anëtarëve për një kandidat tjetër për Kryeprokuror.

Duke pasur parasysh lirinë e vlerësimit të secilit kandidat, diskrepanca kaq të gjera të vlerësimit krijojnë perceptimin se ka pasur kandidatë të preferuar në mesin e anëtarëve të panelit vlerësues.

Tutje, sipas nenit 13.4. të Rregullores Nr.07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, pyetjet e parashtruara për të gjithë kandidatët duhet të jenë standarde. Megjithatë, në një rast, IKD gjeti se njërit prej kandidatëve nuk i është parashtruar fare një pyetje e cila iu parashtrua kandidatëve të tjerë.

Njëra prej pyetjeve të parashtruara nga njëri prej anëtarëve të panelit vlerësues ishte *“Garancitë Kushtetuese në procedurë penale, interpretimi i të drejtave dhe lirive të njeriun në rastin e Kosovës dhe interpretimi i instrumenteve ndërkombëtare në kontekst të Kosovës”*. Në bazë të bindjes së krijuar gjatë procesit të monitorimit, kjo pyetje ishte e paqartë dhe krijoi konfuzitet tek kandidatët e intervistuar.

Tutje, në bazë të arsytimit të poentimit nga anëtarët e panelit vlerësues, në shumë raste, arsyetimi ndërlidhej me çështjet e performancës së kandidatëve, duke u referuar në vlerësimin e performancës së kandidatit, përkundër se për këtë pjesë, kishte pyetje specifike të parashtruara gjatë procesit të intervistimit të cilat ndërlidheshin me performancën. Këtu bënte pjesë arsyetimi në lidhje me aftësitë e kandidatit për kualifikimin e veprave penale, njohuritë në lidhje me aplikimin e dispozitave të procedurës penale dhe procedurës paraprake etj.

Sipas Ligjit NR. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit [neni 28], vlerësimi i dalluar apo i mirë i performancës në dy (2) vlerësimet e fundit është kriter formal për t’iu futur garës për Kryeprokuror. Vlerësimi i performancës llogaritet performancën profesionale të Prokurorit në kryerjen e detyrave të punës, por jo aftësitë menaxheriale për pozitën e Kryeprokurorit. Për këtë arsye, marrja parasysh e rezultateve të vlerësimit të performancës paraqet një lloj përlllogaritje të dyfishtë të të njëjtit proces.

Në anën tjetër, arsyetimi i poentimit me vlerësim të performancës për disa kandidatë dhe mos aplikimi i vlerësimit të performancës si arsyetim për disa kandidatë të tjerë, krijon perceptimin e një qasje jo të barabartë të kandidatëve.

4. Rrjedha e procesit për përzgjedhjen kryeprokurorëve të prokurorive themelore

Për dallim nga procesi për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, IKD nuk ka identifikuar probleme të theksuara në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për kryeprokurorë të prokurorive themelore. Përkundër evidentimit të disa problemeve minore, përgjithësisht, procesi përzgjedhës ka qenë i bazuar në Ligj dhe Rregullore, derisa kandidatët janë trajtuar në mënyrë të barabartë.

Me qëllim të përmirësimit të qartësisë së pyetjeve, bazuar në përvojat e procesit për Kryeprokuror të Prokurorisë së Apelit, panelet vlerësuese kanë ri-formuluar disa prej pyetjeve, me qëllim të qartësisë së tyre, duke i bërë pyetjet më specifike. Kjo qasje ka ngritur mundësinë për vlerësim më meritore dhe real të kandidatëve.

Tutje, për dallim nga procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Apelit, IKD nuk ka evidentuar disbalancë të theksuar të vlerësimit të kandidatëve. Dallimet në poentim mbesin brenda vlerësimit të lirë të anëtarëve të paneleve vlerësuese.

Referimi jo adekuat në rezultatet e procesit të vlerësimit të performancës evidentohet edhe në procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore. Në bazë të arsytimit të poentimit nga anëtarët e panelit vlerësues, në disa raste, arsytimi ndërlidhej me çështjet e performancës së kandidatëve, duke u referuar në vlerësimin e performancës së kandidatit, përkundër se për këtë pjesë, kishte pyetje specifike të parashtruara gjatë procesit të intervistimit të cilat ndërlidheshin me performancën. Këtu bënte pjesë arsytimi në lidhje me kualifikimin e veprave penale, arritja e normës orientuese etj.

Sipas Ligjit NR. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit [neni 28], vlerësimi i dalluar apo i mirë i performancës në dy (2) vlerësimet e fundit është kriter formal për t'iu futur garës për Kryeprokuror. Vlerësimi i performancës llogaritet performancën profesionale të Prokurorit në kryerjen e detyrave të punës, por jo aftësitë menaxheriale për pozitën e Kryeprokurorit. Për këtë arsye, marrja parasysh e rezultateve të vlerësimit të performancës paraqet një lloj përlllogaritje të dyfishtë të të njëjtit proces.

Në anën tjetër, edhe tek ky proces, arsytimi i poentimit me vlerësim të performancës për disa kandidatë dhe mos aplikimi i vlerësimit të performancës si arsytim për disa kandidatë të tjerë krijon perceptimin e një qasje jo të barabartë të kandidatëve.

5. Transparenca e procesit

Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe pesë (5) kryeprokurorëve të prokurorive themelore ka qenë një proces kryesisht transparent. Para fillimit të këtij procesi, shoqëria civile është ftuar që ta monitorojë këtë proces. Gjatë zhvillimit të procedurave të intervistimit, nuk janë evidentuar pengesa për monitorimin e procesit.

Megjithatë, Panelet Vlerësuese nuk dhanë qasje të plotë në arsyetimet në lidhje me poentimin e kandidatëve për kryeprokurorë. Me datë 26 Dhjetor 2024, KPK ka ftuar monitoruesit për t'ua vënë në shikim arsyetimet, por duke mos i dhënë kopjet e këtyre fletë arsytiveve. Kjo praktikë konsiderohet e panevojshme dhe dhënia e dokumenteve të plota lidhur me arsyetimin e poentimit nuk dëmton asgjë procesin, përderisa procesi është monitoruar dhe madje arsyetimet u vihen në shikim.

Për këtë arsye, IKD rekomandon që në fazat pasuese, KPK të publikojë arsyetimin e poentiveve për secilin kandidat.

6. Barazia gjinore

Problematike në këtë proces ishte pjesëmarrja e ulët e kandidateve gra. Nga 15 kandidatët për kryeprokurorë të gjashtë (6) prokurorive, vetëm pesë (5) prej tyre kanë qenë gra. Madje, kandidate gra për Kryeprokurore kishte vetëm në Prokurorinë Themelore të Pejës dhe të Apelit, derisa për katër (4) prokurori të tjera, gara zhvillohej në mes burrave.

KPK duhet të veprojë përballë kësaj situatë në bazë të nenit 4 të Ligjit për Barazi Gjinore, duke ndërmarrë masa të veçanta për rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset për përzgjedhjen e Kryeprokurorëve.